

D.2 VENDOSJA E PARAMETRAVE TË HYRJES PËR PËRGATITJEN E RAPORTEVE

Specifikoni kriteret për zgjedhjen e të dhënave në dritaren **Vendos parametrat për krijimin e raportit**.

D.2.1 Statistikat Huazimi-BibSiSt-01, Huazimi - BibSiSt-11, Huazimi -BibSiSt-21 dhe Huazimi -BibSiSt-31

Kur krijoni raporte statistikore specifikoni vlerat e parametrave të mëposhtëm:

- "Periudha"

Specifikoni periudhën që duhet të merret parasysh gjatë krijimit të raportit statistikor të anëtarëve aktivë.

Vendosja e parametrat është e detyrueshme.

"Transaksioni"

Zgjidhni transaksionet (aktivitetet e anëtarëve) që duhet të merren parasysh në raportin statistikor të anëtarëve aktivë.

Transaksionet e mëposhtme zgjidhen si parazgjedhje: *regjistrimi i anëtarit, përditësimi i shënimit të përkohshëm në lidhje me materialin, huazimi jashtë bibliotekës, huazimi në sallën e leximit, rezervimi i materialit aktualisht i padisponueshëm, rezervimi i materialit në dispozicion, shtyrja e afatit të huazimi, kthimi/fshirja e materialit nga regjistrat e anëtarit, kthimi me kufizim, evidentimi i humbjes së materialit, ndryshimi i të dhënave të anëtarit, fshirja e kopjes, ndryshimi i datës së kthimit, fillimi i qarkullimit të serialeve, vizita nga anëtari (qasja në internet), rezervimi i dhomës së leximit, rinovimi përmes telefonit, fundi i qarkullimit të serialeve, regjistrimi i pagesës, vizita e anëtarit në sallën e leximi), aktiviteti i anëtarit me huazimin e pajisjeve në inventar, huazimi ndërbibliotekar, kthimi i materialeve përmes huazimit ndërbibliotekar, regjistrimi në internet (online), ndryshimi i të dhënave përmes COBISS+ dhe mCOBISS, ndryshimi i numrit, rezervimi i materialit aktualisht të padisponueshëm përmes COBISS+ dhe mCOBISS, rezervimi i materialit në dispozicion përmes COBISS+ dhe mCOBISS, shtyrja e afatit të huazimit përmes COBISS+ dhe mCOBISS, anulimi i rezervimit përmes COBISS+ dhe mCOBISS, vizitë nga anëtari - të ndryshëm.*

Vendosja e parametrut është fakultative. Nëse nuk zgjidhet asnjë transaksion, të gjitha transaksionet merren parasysh gjatë përpilimit të statistikave.

D.2.2 Statistikat Huazimi-BibSiSt-02, Huazimi-BibSiSt-12, Huazimi-BibSiSt-22 dhe Huazimi-BibSiSt-32

Kur krijoni raporte statistikore specifikoni vlerat e parametrut vijues:

- "Periudha"

Specifikoni periudhën për të cilën të dhënat duhet të merren parasysh në raportin statistikor.

Vendosja e parametrut është e detyrueshme.